

BACHELOR NË "INXHINIERI MEKANIKE"

OBJEKTIVAT E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Programi Bachelor në "Inxhinieri Mekanike" synon të zhvillojë aftësitë kryesore inxhinierike, veçanërisht në sistemet mekanike, materialet, termodinamikën, mekanikën e fluideve dhe elektroteknikën. Ai gjithashtu formon kompetenca ndërdisiplinore, duke inkurajuar integrimin me fusha si automatika, ekonomia, programimi dhe menaxhimi i projekteve. Programi gjithashtu promovon përgatitjen praktike dhe profesionale përmes praktikave, vizatimeve teknike, teknologjive CAD dhe CNC, si dhe punës laboratorike. Gjithashtu, përmes trajnimeve në shkrim akademik, metoda kërkimi ofron përgatitje për studime apo karrierë të mëtejshme në inxhinieri dhe industri.

REZULTATET E TË NXËNIT

Në përfundim të programit, studentët diplomuar duhet të jenë në gjendje të:

- Zbatojnë parimet shkencore të matematikës, fizikës dhe kimisë për të analizuar dhe zgjidhur probleme të inxhinierisë mekanike.
- Projektojnë dhe analizojnë sisteme dhe procese mekanike duke përdorur mjete dhe teknika moderne, përfshirë CAD dhe CNC dhe marrë në konsideratë funksionalitetin, qëndrueshmërinë, prodhueshmërinë dhe sigurinë.
- Kuptojnë dhe përdorin konceptet themelore të shkencës së materialeve, mekanikës së fluideve, termodinamikës dhe analizës strukturore.
- Demonstrojnë aftësi të programimit dhe algoritmikës të rëndësishme për automatizimin dhe integrimin e sistemeve.
- Kryejnë eksperimente dhe interpretojnë të dhëna, veçanërisht në matjet mekanike dhe fizikën teknike.
- Vlerësojnë dhe përzgjedhë materialet më të përshtatshme mekanike për secilin projekt, bazuar në performancën, koston dhe qëndrueshmërinë e tyre.
- Mbikëqyrë zbatimin e teknologjive moderne mekanike, duke përfshirë makineritë dhe sistemet mekanike, për të rritur efikasitetin dhe cilësinë e projekteve.
- Zbatojnë rregullat dhe standardet e sigurisë në impiantet mekanike, për të siguruar mbrojtjen e punonjësve dhe për të minimizuar rreziqet gjatë proceseve mekanike industriale.
- Komunikojnë në mënyrë efektive, si në formatin e shkruar ashtu edhe në atë verbal, dhe të punojnë në ekipe shumëdisiplinore.
- Menaxhojnë projekte inxhinierike, përfshirë planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e tyre.
- Angazhohen në të nxënë gjatë gjithë jetës, duke qëndruar të përditësuar me përparimet teknologjike dhe praktikatat inxhinierike.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Të diplomuarit në programin e studimit mund të punësohen si:

- Inxhinier mekanik projektues në studio projektimi dhe kompani prodhimi, ku zhvillohen projekte të sistemet mekanike, produkte dhe procese industriale.
- Menaxher projektesh në kompani prodhimi, ndërtimi ose në zyrat e administratës publike, për planifikimin dhe menaxhimin e projekteve inxhinierike mekanike.
- Inxhinier prodhimi në industri të vogla, të mesme ose të mëdha, për zhvillimin dhe menaxhimin e linjave të prodhimit dhe procesve teknologjike.



**Universiteti
European i
Tiranës**

maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



Institution accredited
European University of Tirana
Valid 12/2022 - 12/2027

- Inxhinier mirëmbajtjeje në kompani që ofrojnë shërbime për mirëmbajtjen dhe servisin e makinerive, pajisjeve mekanike dhe sistemeve industriale.
- Inxhinier HVAC për projektimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të ngrohjes, ventilimit, ftohjes dhe kondicionimit të ajrit në kompani të specializuara.
- Inxhinier i sigurisë industriale në kompani që ofrojnë konsulencë dhe mbikëqyrje për zbatimin e standardeve të sigurisë në procese mekanike.
- Konsulent inxhinierik në kompani që ofrojnë shërbime të projektimit dhe zhvillimit të sistemeve mekanike për industrinë dhe sektorët e tjerë.
- Ekspert në zhvillimin e proceseve mekanike dhe automatizimit për kompani të fokusuara në teknologji dhe automatizim të proceseve industriale.
- Inxhinier i sistemeve të energjisë dhe energjisë së rinovueshme, ku kontribuon në projektimin dhe implementimin e sistemeve energjetike mekanike dhe të rinovueshme.
- Konsulent për optimizimin e proceseve industriale për agjenci qeveritare dhe private që ofrojnë mbështetje për përmirësimin e efikasitetit dhe cilësisë së prodhimit.
- Asistent kërkimesh dhe zhvillimi (R&D) në kompani akademike ose private, ku kontribuon në zhvillimin e teknologjive dhe produkteve të reja mekanike.
- Inxhinier teknologjie për implementimin dhe monitorimin e sistemeve të avancuara mekanike dhe automatikës në industri të ndryshme.
- Profesionist i lirë, pas pajisjes me licencat përkatëse, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

BA INXHINIERI MEKANIKE (180 ECTS)

Nr.	Viti	Sem	Emërtimi i Lëndës	ECTS
-----	------	-----	-------------------	------

A – LËNDË BAZË

Përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (15 – 20%) - 32 ECTS

1	I	1	Algjebër dhe Gjeometri	6
2	I	1	Analizë Matematike 1	6
3	I	2	Analizë Matematike 2	6
4	I	2	Shkrim akademik dhe Metoda kërkimi	8
5	II	1	Hyrje në ekonomi	6

32

B – LËNDË KARAKTERIZUESE

Përgatitje për disiplinën shkencore (50 – 55%) - 95 ECTS

1	I	1	Kimi e përgjithshme dhe inorganike	6
2	I	1	Vizatim teknik industrial e CAD	3
3	I	1	Fizikë I	5
4	I	2	Fizikë II	6
5	I	2	Shkenca dhe teknologjia e materialeve	5
6	I	2	Gjeometri deskriptive 1	5
7	II	1	Algoritmikë dhe Hyrje në programim	6
8	II	1	Bazat e elektroteknikës	8
9	II	2	Hyrje në probabilitet	6
10	II	2	Shkenca e konstruksioneve (1)	5
11	II	2	Mekanika racionale	6
12	II	2	Fizikë teknike dhe ambientale	6
13	II	1	Mekanika e fluideve	6
14	III	1	Baza të mekanikës së aplikuar dhe elemente makinash	8
15	III	1	Hyrje në menaxhimin e operacioneve	6
16	III	1	Impiantet industriale	8

95

C – LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE

Nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (12 – 15%) - 26 ECTS

1	II	2	Bazat e automatikës	6
2	III	1	Makina dhe Sisteme Mekanike	6
3	III	1	Matje mekanike	6
4	III	1	Shkenca e konstruksioneve (2)	5
5	III	2	Teknologji mekanike e CNC (Computer Numerical Control)	6
6	III	2	Sistemet e transportit, infrastruktura dhe siguria	8

26

D – LËNDË PLOTËSUESE

Gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale (10 – 15%) - 20 ECTS

1	II	1	Anglisht	5
2	I	1	Bazat e Informatikës	4
3	III	1	Hartim dhe menaxhim projektsh	6
4	III	2	Praktikë profesionale dhe zhvillim studenti	5

20

E – DETYRIME PËRMBYLLËSE

Referenca (3 – 5%) - 7 ECTS

1	III	2	Punimi i diplomës/Provimi i Përgjithshëm Përfundimtar	7
---	-----	---	---	---

Totali

180